

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6226  
E premte, 29 janar 2021  
çmimi 0.40 €

## Administrata e Bidenit mbështet dialogun Kosovë - Serbi të lehtësuar nga BE-ja



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KMDLNJ-ja KUNDËRSHTON SPECIALEN PËR MOSLIRIMIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së




Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka theksuar se gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës Speciale, Nicolas Guillo, sipas parimit "hip se të vrava, zhdryp se të vrava", po i refuzon të gjitha kërkesat e avokatëve të të akuzuarve, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa, Hashim Thaçi, Jakup

Krasniqi, Rexhep Selim dhe Kadri Veseli, për t'u mbrojtur në liri. "Nuk ka argument që e ofrojnë avokatët mbrojtës e që nuk refuzohet nga ky gjykatës e që lehtësisht mund të dyshohet për pjesëmarrje për rrjedhje të dosjeve të ndjeshme e që kanë përfunduar para zyrave të OVL-së së UÇK-së", është thënë në reagimin e KMDLNJ-së

FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ

# REZULTATI I 14 SHKURTIT ËSHTË I QARTË



Politologu Belul Beqaj ka bërë me dije se fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit do të jetë Lëvizja Vetëvendosje. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka bërë me dije se koalicionit të ri

qeverisës do t'i duhet edhe një subjekt për t'i formuar institucionet e reja. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka vlerësuar se partitë që kanë qenë deri më tani në pushtet do të zbesin gradualisht

nga skena politike të cilën e kanë dominuar në periudha të ndryshme. Sipas tij, aktivitetet e partive politike me shumë njerëz po dëshmojnë se për to gara për pushtet ka përparesi karshi shëndetit të qytetarëve

## OPINION

ÇFARË PËRMBANTE AKTAKUZA E FABRIKUAR PËR TETË USHTARËT E KAZERMËS SË PARAQINIT? F. 8



Shkruan:  
Lulzim SAHITI

## AKTUALE



ZEMAJ: VAKSINA KUNDËR COVIDIT VJEN NË SHKURT F. 6

LAJÇAKU: SHKËMBIMI I TERRITOREVE DO TË ISHTE SHUMË I RREZIKSHËM F. 7

## EKONOMI

ATK-ja MBLODHI 78 MILIONË EURO MË PAK GJATË VITIT 2020 F. 9

JOEFIKASITETI I GJYQËSORIT PO DEKURAJON INVESTIMET E HUAJA NË KOSOVË F. 10



## SPORT

KOSOVA NË MARS ZHVILLON MIQËSORE NDAJ LITUANISË F. 12



# KDI-ja THOTË SE PO VAZHDON NGEÇJA NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT NË KOSOVË

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Gjermania me kufizime udhëtimit për vendet me variante të reja të koronavirusit

**BERLIN, 28 JANAR** - Gjermania po ndalon shumicën e udhëtarëve nga vendet e goditura me variantet e reja të koronavirusit, tha të enjten ministri i Brendshëm, Horst Seehofer. "Ne jemi duke i përqendruar këto kufizime të udhëtimit në zonat e mutacionit, të cilat aktualisht janë Britania e Madhe,

Portugalia, Afrika e Jugut dhe Brazili", tha ai. Shfaqja e varianteve të reja të koronavirusit në Britani të Madhe, Brazil dhe Afrikën e Jugut, që konsiderohen më infektive sesa lloji original, ka nxitur shqetësimin në shumë vende që po përpiqen ta frenojnë pandeminë. Portugalia, e cila ka lidhje të

shumta ajrore me Brazilin, gjithashtu ka raportuar së fundmi një numër të lartë të të infektuarve pasi e kaloi valën e parë të koronavirusit relativisht mirë. Seehofer tha se bisedimet janë duke vazhduar për të vendosur se cilës kategori udhëtarësh mund t'i lejohet për të hyrë në Gjermani.

Këto kategori mund të përfshijnë gjermanët që kthehen, si dhe ata që punojnë në transportin e mallrave, pasi fluturimet e ngarkesave nuk duhet të ndërpriten. Ministri i Brendshëm theksoi se Gjermania do të paraqesë detaje mbi ndalimin e udhëtimit të premtën dhe mezi pret që BE-ja të marrë një



vendim të përbashkët për një çështje kaq të ngutshme shëndetësore për popullatën.

## Gjykata ruse refuzon apelin e Navalnyt për lirim nga burgu

**MOSKË, 28 JANAR** - Një gjykatë në Rusi ka urdhëruar mbajtjen në burg të kritikut të Kremlinit, Aleksei Navalny, pasi ka refuzuar apelin kundër ndalimit të tij.

Navalny e ka cilësuar të pritshëm këtë vendim.

Kritiku i presidentit rus, Vladimir Putin, është dërguar në mbajtje për 30 ditë nga 18 janari, pak pasi është kthyer nga Gjermania në Rusi, ku është trajtuar për helmim me agjent nervor, "noviçok".

Gjykata atëbotë e ka ndaluar për shkelle të dënimit me kusht,

gjë të cilin ai e ka mohuar. Për shkak të rasteve ligjore kundër tij, Navalny, 44-vjeçar, mund të përballet me burgim. Perëndimi ka kërkuar nga Navalny lirin e tij, pasi dhjetëra mijëra protestues kanë dalë nëpër rrugët e Rusisë të shtunën për ta kundërshtuar ndalimin e tij. Teksa i është adresuar gjyqtarit të procedurës paraprake me një video-link nga burgu, Navalny ka kërkuar të lirohet dhe ka kundërshtuar ato që i ka cilësuar supozime absurde të autoriteteve ruse, të bazuara në qëllime politike.



## Frontex tërhiqet nga kufiri Hungari - Serbi



**BUDAPEST, 28 JANAR** - Agjencia kufitare e Bashkimit Evropian "Frontex" ka njoftuar se ka pezulluar të gjitha operacionet në Hungari. Masa vjen pas një vendimi të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë që kritikoi rëndë sistemin e azilit të Hungarisë. "Frontex" ka pezulluar të gjitha aktivitetet e tij operacionale në Hungari", i tha AFP-së, Chris Borowski, një zëdhënës i "Frontex"-it, me bazë në Varshavë. "Përpjekjet tona të përbashkëta për t'i mbrojtur kufijtë e BE-së mund të jenë të suksesshme vetëm nëse bashkëpunimi dhe aktivitetet të jenë plotësisht në përputhje me ligjet e BE-së", tha ai. Gjykata Evropiane e Drejtësisë në dhjetor gjeti mangësi të

shumta në procedurat e azilit të Hungarisë, duke përfshirë kthimin e paligjshëm të migrantëve nga Serbia.

Gjykata, gjithashtu, kritikoi ndalimin e migrantëve në "zonat e transitit".

Komisionarja e BE-së për Punët e Brendshme, Ylva Johansson, shkroi në "Twitter" se njoftimi i "Frontex"-it ishte "i mirëpritur". Komiteti i Helsinkit në Hungari (HHC) tha se Hungaria kishte kthyer më shumë se 4 400 migrantë që nga vendimi i gjykatës së BE-së.

Migrantët, kryesisht nga vendet e Lindjes së Mesme, shkojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor për të kaluar pastaj më lehtë në territorin e Bashkimit Evropian.

## Borxhi publik i Kroacisë rritet në 86.4 për qind të GDP-së

**ZAGREB, 28 JANAR** - Në fund të shtatorit 2020, borxhi publik i Kroacisë arriti në 325.2 miliardë kuna (46.58 miliardë euro), që është 11.2 për qind më shumë se në fund të vitit 2019, sipas të dhënave të fundit nga Banka Kombëtare Kroate (CNB). Rritja e borxhit publik është kryesisht pasojë e rritjes së shpenzimeve publike për shkak të luftës kundër pandemisë Covid-19 dhe analistëve të Raiffeisen Bank

Austria (RBA) vërejnë se pjesa e saj në GDP ishte 86.4 për qind. Krahasuar me fundin e vitit 2019, borxhi publik kroat në shtator 2020 ishte më i lartë për 32.8 miliardë kuna (4.33 miliardë euro) dhe, krahasuar me gushtin, ishte më i lartë për 462.8 milionë kuna (61.21 milionë euro), ose me 0.1 për qind.

Sipas parashikimeve të analistëve të RBA-së, nevojat

për financimin e deficitit buxhetor dhe detyrimet financiare të Kroacisë që po maturohen këtë vit arrijnë në rreth 17 për qind të GDP-së. Me deficitin e buxhetit të pritur prej trepërqindësh të PBB-së, në tremujorin e parë të këtij viti do të mblidhen 1.5 miliardë eurobono dhe më pas në korrik, gjashtë miliardë kuna të bonove të brendshme do të maturohen (rreth 793.4 milionë euro).



# KMDLNj kundërshton Specialen për moslirimin e ish-krerëve të UÇK-së

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka theksuar se gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës Speciale, Nicolas Guillo, sipas parimit “hip se të vrava, zhdryp se të vrava”, po i refuzon të gjitha kërkesat e avokatëve të të akuzuarve, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Rexhep Selim dhe Kadri Veseli, për t’u mbrojtur në liri. “Nuk ka argument që e ofrojnë avokatët mbrojtës e që nuk refuzohet nga ky gjykatës e që lehtësisht mund të dyshohet për pjesëmarrje në rrjedhje të dosjeve të ndjeshme e që kanë përfunduar para zyrave të OVL-së së UÇK-së”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së



## “Epoka e re”

PRISHTINË, 28 JANAR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave të Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar ndaj vendimit të Gjykatës Speciale për moslirimin me kusht të ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Në reagimin për media, KMDLNj ka kundërshtuar vendimin e gjykatësit Nicolas Guillou për vazhdimin e paraburgimit për Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin, Kadri Veselin dhe Salih Mustafën. “Gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës Speciale, Nicolas Guillou, sipas parimit ‘hip se të vrava, zhdryp se të vrava’, po i refuzon të gjitha kërkesat e avokatëve të të akuzuarve, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj, Salih Mustafa, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Rexhep Selim dhe Kadri Veseli, për t’u mbrojtur në liri. Nuk ka argument që e ofrojnë avokatët mbrojtës e që nuk refuzohet nga ky gjykatës, që lehtësisht mund të dyshohet për pjesëmarrje në rrjedhje të dosjeve të ndjeshme që kanë përfunduar para zyrave të OVL-së së UÇK-së, pas të cilit

veprim u arrestuan Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, me arsyetimin se, duke e zbuluar identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur, seriozisht po e rrezikojnë jetën e këtyre dëshmitarëve dhe familjeve të tyre. Po të kishin bërë hetime brenda Gjykatës Speciale për rrjedhje të dosjeve të ndjeshme dhe po të ishin ndërmarrë veprime ligjore ndaj atyre që i kanë dërguar këto dosje në zyrat e OVL-së së UÇK-së, atëherë edhe do të arsyetohej arrestimi i krerëve të OVL-së së UÇK-së. Mirëpo, pasi nuk ishte bërë asnjë hetim dhe askush nga stafi i Gjykatës Speciale në Hagë nuk është marrë në përgjegjësi, arrestimin e Hysni Gucati dhe të Nasim Haradinajt, KMDLNj-ja e konsideron vetëm si pretekst për arrestimin e krerëve institucionalë dhe të UÇK-së”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, dosjet e kontrabanduara nga Gjykata Speciale, qoftë se janë shitur me një çmim të majmë, që janë dhënë për qëllime politike apo të tjera, kanë shërbyer si përshpejtuese për arrestimin

politik, pasi kanë prodhuar efekte dhe pasoja të drejtpërdrejta politike të Hysni Gucati, Nasim Haradinajt, Hashim Thaçit, Rexhep Selimit, Jakup Krasniqit dhe Kadri Veselit. “Rrjedhja e dosjeve top-sekrete nga Gjykata Speciale është punë e një grupi të organizuar kriminal e që deri më tani nuk është zbuluar për faktin se as që janë bërë përpjekje të zbulohet. Motivi pse e kanë bërë këtë nuk dihet derisa nuk zbulohet ky grup kriminal brenda Gjykatës Speciale. Të dyshuar për këtë veprimtari kriminale që skajshmërisht e rrezikon jetën e dëshmitarëve të kësaj gjykate janë të gjithë të punësuarit në këtë gjykatë, nga kryeprokurori Jack Smith e deri te gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou. Për këtë arsye është dashur të bëhen hetime në mënyrë që të zbulohet adresa e përgjegjësive. Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati janë viktima të manipulimit nga Gjykata Speciale që i ka lëshuar në qarkullim dosjet e ndjeshme”, është thënë në këtë reagim.

KMDLNj ka theksuar se Nicolas

Guillou si dhe Jack Smith, në kërkesën për caktim të paraburgimit si dhe në vendimin për refuzim të liritimit për të paraburgosurit, argumentin kryesor e kanë rrezikimin e jetës së dëshmitarëve të mbrojtur dhe të dëshmitarëve vullnetarë të Gjykatës Speciale. “Pikërisht Gjykata Speciale, me livrimin e dosjeve të ndjeshme të kësaj gjykate, për motiv të panjohur, përveçse mund të paragjykohet, në mënyrën më të vrazhdë dhe të drejtpërdrejtë e ka rrezikuar jetën e dëshmitarëve të mbrojtur. Në anën tjetër, po kjo prokurori dhe gjykatë në çdo kërkesë dhe arsyetim të vendimit përmendin emra dhe mbiemra të personave që kanë dhënë intervista apo prononcime që këta e vlerësojnë se mund të përdoren si dëshmi dhe në këtë mënyrë ua rrezikojnë jetën drejtpërdrejt. Rasti më flagrant është i ish-këshilltarit të Albin Kurtit, prononcimet e të cilit prokuroria dhe Gjykata Speciale i përdorin si argumente kyçe për t’i mbajtur në burg ish-krerët e UÇK-së, duke ua rrezikuar jetën si dhe

duke rrezikuar jetën e familjeve të tyre. Ky manipulim i prokurorisë dhe Nicolas Guillout profesionalisht është i dëmshëm, kurse moralisht i ulët sepse në njërin anë kinse përipiqet ta mbrojë identitetin e dëshmitarëve të mbrojtur, në anën tjetër, duke përsëritur, me emër dhe mbiemër secilin që i shkon në favor, i shndërron në shënjestra që rrezikohen 24 orë dhe të cilët nuk janë fare të mbrojtur”, theksohet në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, as Prokuroria e as Gjykata Speciale nuk kanë të drejtë t’i keqpërdorin deklaratat dhe prononcimet e personaliteteve publike siç po bëjnë tani, duke ua rrezikuar jetën drejtpërdrejt, sepse po i cilësojnë si persona që po i mbajnë në burg ish-krerët e UÇK-së e që nuk është fare e vërtetë. “Dhe, si argument i fundit e të cilin KMDLNj e konsideron paragjykim të tmerrshëm dhe në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë, është fakti se edhe prokurori Jack Smith, në kërkesën për vazhdimin e paraburgimit, sikur edhe gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, në arsyetimin për refuzimin e liritimit, deri në gjykim deklarojnë se mund të dënohen me burgim të përjetshëm, ndonëse gjykimi as që ka filluar. Nëse prokurori edhe mund të kërkojë këtë dënim, gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, nuk mund t’i nënshtrohet paragjykimit pa përfunduar ende gjykimi. Siç po shkojnë punët, kur e ashtuquajtura Gjykatë Kushtetuese e Gjykatës Speciale dhe një institucion, për fat të keq, i quajtur Ombudsperson, nuk po reagojnë fare dhe nuk po bëjnë asnjë veprim për t’i mbrojtur të drejtat e njeriut, qoftë ato të personave të privuar nga liria, kërcënimet e kryeprokurorit Jack Smith dhe gjykatësit të procedurës paraprake, Nicolas Guillou, nuk mund edhe të merren si paragjykime, por seriozisht duhet të konsiderohen qëllime të tyre, pavarësisht prej mjeteve për realizim të atyre qëllimeve e që janë në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut!”, thuhet në reagimin e KMDLNj-së.





FLET PËR "EPOKËN E RE", BELUL BEQAJ

## Rezultati i 14 shkurtit është i qartë

Politologu Belul Beqaj ka bërë me dije se fituese e zgjedhjeve të 14 shkurtit do të jetë Lëvizja Vetëvendosje. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka bërë me dije se koalicionit të ri qeverisës do t'i duhet edhe një subjekt për t'i formuar institucionet e reja. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka vlerësuar se partitë që kanë qenë deri më tani në pushtet do të zbresin gradualisht nga skena politike të cilën e kanë dominuar në periudha të ndryshme. Sipas tij, aktivitetet e partive politike me shumë njerëz po dëshmojnë se për to gara për pushtet ka përparësi karshi shëndetit të qytetarëve

ndryshim. "Do të ishte në kuadër të frymës për ndryshim nëse zgjidhet kandidatja e Vetëvendosjes dhe Iniciativës - Vjosa Osmani, nëse zgjidhet pretendenti i AAK-së do të vështirësohet seriozisht përcaktimi i shumicës së qytetarëve për ndryshim", ka thënë ai.

shumicës së qytetarëve për shkak të mënyrës se si kanë qeverisur derisa kanë qenë në pushtet.

**"Epoka e re":** Si e parashikoni rezultatin e zgjedhjeve të 14 shkurtit? Deri më tani kemi parë disa sondazhe, por disa subjekte politike i kanë kontestuar?

**Beqaj:** Besoj se rezultati i zgjedhjeve është i qartë. Fituese do të jenë LV-ja dhe iniciativa e Vjosa Osmani. Duket se koalicioni qeverisës do të përfshijë edhe një subjekt, shpresoj të reformuar politik. Zgjedhësit do të përcaktohen kryesisht për ndryshime, ndërsa partitë që kanë qenë deri tashti në pushtet do të zbresin gradualisht nga skena politike në të cilën kanë dominuar në periudha të ndryshme deri më tashti.

**"Epoka e re":** Siç e kemi parë, KQZ-ja dhe PZAP-ja, duke marrë për bazë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, nuk i kanë certifikuar disa kandidatë për deputetë, përfshirë edhe liderin e

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 28 JANAR** - Politologu Belul Beqaj ka bërë me dije se fituesi i zgjedhjeve të 14 shkurtit do të jetë i qartë. Ai ka thënë se qytetarët për këto zgjedhje të parakohshme parlamentare do të përcaktohen kryesisht për ndryshime.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Beqaj ka vlerësuar se partitë që kanë qenë deri më tani në pushtet do të zbresin gradualisht nga skena politike. "Besoj se rezultati i zgjedhjeve është i qartë. Fituese do të jenë LV-ja dhe iniciativa e Vjosa

Osmanit. Duket se koalicioni qeverisës do të përfshijë edhe një subjekt, shpresoj të reformuar politik. Zgjedhësit do të përcaktohen kryesisht për ndryshime, ndërsa partitë që kanë qenë deri më tani në pushtet do të zbresin gradualisht nga skena politike në të cilën kanë dominuar në periudha të ndryshme deri më tashti", ka thënë Beqaj.

Ai ka komentuar edhe parafushatën që po e bëjnë partitë politike prej shpalljes së zgjedhjeve. Beqaj ka thënë se përmes këtyre aktiviteteve partitë politike dëshmojnë se për to gara për pushtet ka supremacion

karshi shëndetit të qytetarëve. "Mendoj se parafushata dhe fushata nuk do të ndikojnë vendosmërisht në zgjedhje ngaqë qytetarët janë përcaktuar për rrënimin e Qeverisë Kurti për fituesin LV-VO. Ndërsa partitë e tjera po bëjnë fushatë të (pa)vetëdijshme se ato e kanë humbur besimin e shumicës së qytetarëve për shkak të mënyrës se si kanë qeverisur derisa kanë qenë në pushtet!", është shprehur Beqaj.

Ai ka thënë se nëse legjislatura që do të dalë nga zgjedhjet e 14 shkurtit do ta zgjedhë për presidenti kandidatit e AAK-së, do të ishte kundër frymës për



# Administrata e Bidenit mbështet dialogun Kosovë - Serbi të lehtësuar nga BE-ja

PRISHTINË, 28 JANAR - Shtetet e Bashkuara mbështesin në mënyrë të plotë dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian që ka përsëritur synim arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, thuhet në një deklaratë të Departamentit Amerikan të Shtetit për "Radion Evropa e Lirë".

Në lidhje me zgjedhjen e çështjes në mes të Kosovës dhe Serbisë, Departamenti i Shtetit rikujton një deklaratë të mëherëshme të presidentit amerikan, Joe Biden. "Siç ka thënë presidenti Biden: thelbësore për ecjen përpara të

Kosovës dhe Serbisë është një zgjidhje gjithëpërfshirëse, e cila do të çojë në njohje të ndërsjellë; do ta ruajë sovranitetin dhe integritetin territorial të të dyja shteteve, si dhe do t'i fuqizojë institucionet demokratike të tyre. Ajo do ta rriste sigurinë dhe prosperitetin e të dyja vendeve, do t'i avanconte aspiratat e tyre për anëtarësim në BE dhe institucione të tjera shumëpalëshe dhe do ta mbështeste qëllimin e qëndrueshëm të një Evrope të tërë, të lirë dhe në paqe". Departamenti i Shtetit rikujton

edhe deklaratën e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, para Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit më 19 janar, para inaugurimit të presidentit Biden, në të cilën ai kishte thënë se "duartroket përpjekjet e administratës së presidentit Trump" për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Presidenti i zgjedhur (Joe Biden), siç e dini, në të kaluarën ka kaluar shumë kohë në ato vende, dhe unë mendoj se ai ndan bindjen se ka gjëra që mund të bëjmë për të ndihmuar që Kosova të lëvizë përpara, gjithashtu me shpresë

edhe Serbia", pati thënë Blinken. Më 4 shtator 2020, Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë në Uashington, dy dokumente për normalizimin e raporteve ekonomike, në prani të ish-presidentit amerikan, Donald Trump. Ato u ndërmjetësuan nga i dërguari i atëherëshëm i Trumpit për dialogun, Richard Grenell. Pas zgjedhjeve presidenciale në Shtetet e Bashkuara, Prishtina dhe Beogradi janë zotuar se do ta vazhdojnë zbatimin e marrëveshjeve, pavarësisht ndryshimit të administratës

amerikane. Dialogu politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ka nisur më 2011. Takimi i fundit ndërmjet krerëve shtetërorë të këtyre vendeve është zhvilluar në shtator të vitit të kaluar. Prej atëherë, nuk është mbajtur takim i nivelit të lartë. Deri në zgjedhjen e Qeverisë së re të Kosovës, Brukseli zyrtar ka paralajmëruar se nuk do të ketë takime në kuadër të dialogut. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbahen më 14 shkurt.



Tom Brenner (Reuters)

LV-së, Albin Kurti. Cili është komenti juaj për këtë proces i cili do të marrë epilog në Gjykatën Supreme?

**Beqaj:** Mendoj se vendimi për moslejimin e Albin Kurtit nuk do të ndikojë shumë në zgjedhje, nëse moskandidimi i tij do ta shumëfishojë mllefën dhe pakënaqësinë e cila mund të reflektohet pas zgjedhjeve në forma të ndryshme varësisht nga rezultati i zgjedhjeve. Moskandidimi do të ngrehë mbështetjen që do t'i reflektojë sjelljet racionale politike, ndërsa moskandidimi ul mbështetjen që do të nënkuptojë sjellje emocionale të cilat mund ta destabilizojnë situatën.

**"Epoka e re":** A mendoni se këto zgjedhje do të sjellin zgjidhje për Kosovën?

**Beqaj:** Jo. Këto zgjedhje do të

bëjnë diskontinuitetin e domosdoshëm i cili potencialisht, për katër deri në tetë vjet, mund të bëjë zgjidhje, nëse mbeten në pushtet duke vepruar në interes të qytetarëve.

**"Epoka e re":** Në këto zgjedhje, përveç kandidatëve për kryeministër, kemi edhe kandidatë për president. Besoni se legjislatura që do të dalë prej këtyre zgjedhjeve do të mund ta zgjedhë edhe presidentin?

**Beqaj:** Do të ishte në kuadër të frymës për ndryshim nëse zgjidhet kandidatja e Vetëvendosjes dhe Inicativës - Vjosa Osmani, nëse zgjidhet pretendenti i AAK-së do të vështirësohet seriozisht përcaktimi i shumicës së qytetarëve për ndryshim.



# Zemaj: Vaksina kundër Covidit vjen në shkurt

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se vaksina kundër Covidit pritet të arrijë në Kosovë në muajin shkurt. Ai ka bërë thirrje për respektimin të masave kundër Covidit, duke kritikuar partitë politike që po mbajnë tubime të mëdha me qytetarët



EPOKA E RE  
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 JANAR - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 652 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 316 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar tri raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë dy raste (85, 81 vjeç), Drenas një rast (74 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 59 304 raste nga 227 482 persona të dyshimtë me

ketë virus dhe 1 482 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 195 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 51 713 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 109.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 116 raste, Prizren 35 raste, Mitrovicë 23 raste, Gjilan 21 raste, Vushtrri 15 raste, Fushë-Kosovë 12 raste, Gjakovë 10 raste, Lipjan 10 raste, Ferizaj 9 raste, Skenderaj 9 raste, Viti 8 raste, Kamenicë 6 raste, Podujevë 6 raste, Rahovec 6 raste, Dragash 5 raste, Klinë 5 raste, Drenas 4 raste, Kaçanik 3 raste, Malishevë 3 raste, Obiliq 2 raste, Pejë 2 raste, Suharekë 2 raste dhe me nga një rast komunat Graçanicë, Istog, Novobërdë dhe Shtime.

Ministri në detyrë i

Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se vaksina kundër Covidit pritet të arrijë në Kosovë në muajin shkurt. Në një konferencë për media ai ka thënë se janë duke punuar maksimalisht që të sigurohet kjo vaksinë. "Jemi duke punuar intensivisht. E mira është që e kemi siguruar zinxhirin e

ftohjes, kurse përgatitjet teknike janë në realizim. Është hartuar strategjia e imunizimit. Procesi i vaksinimit do të fillojë sipas dinamikës dhe sigurimit të vaksinës ashtu siç po pretendojmë jo vetëm ne, por edhe vendet evropiane", ka deklaruar.

Ai ka bërë thirrje për

respektimin e masave kundër Covidit, duke kritikuar partitë politike që po mbajnë tubime të mëdha me qytetarët. "Nuk duhet të presim vetëm gjoha dhe ndëshkime, por duhen respektuar masat. Partitë politike organizojnë tubime e ato janë individuale", ka deklaruar Zemaj.

## PSD-ja: Të falen dënimet ndaj qytetarëve

EPOKA E RE  
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 JANAR - Partia Socialdemokrate (PSD) të enjten ka organizuar një aktivitet simbolik para Ministrisë së Shëndetësisë duke kërkuar që gjatë zbatimit të Ligjit për Pandeminë Covid-19, të trajtohen të gjithë njësoj, edhe qytetarët, por edhe përfaqësuesit e partive politike. "Kjo pandemi, në mënyrën më vulgare, nxori në pah dhe thelloi pabarazinë ekonomike e sociale në mes të njerëzve. Të gjithë po diskutojnë mbi pasojat e përgjithshme të pandemisë ndaj ekonomisë dhe shoqërisë, por pakkush po flet se si janë të shpërndara këto pasoja në mes të shtresave dhe



grupeve të ndryshme shoqërore. Pakkush po flet se si ata që kanë më shumë, veç u pasuruan në pandemia! Pakkush flet se si ata që u

dëmtuan më së shumti janë pikërisht punëtorët privatë edhe ashtu të papaguar mirë. Janë gratë mbi të cilat rëndoi për muaj të tërë mbyllja dhe

kufizimet e lëvizjes", është thënë në komunikatën e PSD-së.

Sipas kësaj partie, në të njëjtën logjikë u shpërnda edhe zbatimi i ligjit në Kosovë. "Ligji rëndoi mbi të dobëtit, kurse u bë llastik për të fortët! Qytetarët u dënuan për mosvendosje të maskave, apo mosrespektim të orarit të lëvizjes, kurse partitë u toleruan në mënyrë abuzive përkundër shkeljeve flagrante të Ligjit për Pandeminë! Kjo pabarazi u bë edhe më e padurueshme kur vetë kryeministri dhe ministri i Shëndetësisë organizuan dhe morën pjesë në aktivitete të jashtëligjshme, në të cilat nuk kishte respektim të asnjë mase për parandalimin e shpërndarjes së Covid-19.

Prandaj sot në mënyrë simbolike vendosëm që t'i rishpërndajmë pasojat e kësaj pandemie. Dënimin 3 milionë euro që shteti ua dha qytetarëve, vendosëm t'ia japim ministrit Armend Zemaj, për zbatimin selektiv që i bëri Ligjit mbi Pandeminë, duke rënduar edhe më shumë jetën e qytetarëve", theksohet në komunikatën e PSD-së. Ky subjekt politik ka kërkuar që të gjithë qytetarët e dënuar gjatë pandemisë të amnistohen urgjentisht nga dënimet e tyre. "Kjo masë do të ishte vetëm një veprim i vogël për ta lehtësuar sadopak barrën e pandemisë që po e vuajnë më së shumti ata që kanë më së paku", është theksuar në komunikatën e PSD-së.

## MSh-ja dhe Posta e Kosovës lansojnë pullën postare dedikuar mantelbardhëve

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Në shenjë nderimi për jetën dhe veprën e profesionistëve shëndetësorë për luftën e tyre kundër koronavirusit dhe mirënjohjes për mantelbardhët që kanë humbur jetën gjatë ballafaqimit me Covid-19, Ministria e Shëndetësisë dhe Posta e Kosovës lansuan të enjten pullën postare dedikuar mantelbardhëve. "Vlerësimi për mjekët dhe infermierët që

humbën jetën në ballafaqim me virusin vdekjeprurës është më e pakta që mund të bëjmë për ta sepse, me veprën e tyre në krye të detyrës, dëshmuuan se janë heronjtë e ditëve tona. Në shenjë nderimi për jetën dhe veprën e mjekëve dhe infermierëve humanë është e jona t'i përkujtojmë dhe vlerësojmë, si shembull të përgjegjësive ndaj shëndetit të qytetarëve, duke lënë një

trashëgimi për gjeneratat. Kjo mirënjohje sot po bëhet edhe nëpërmjet pullës postare", ka deklaruar ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj. Kurse ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv të Postës së Kosovës, Xhevdet Smakiqi, ka thënë se pulla postare është një mirënjohje për mantelbardhët dhe kontributin e tyre të madh për ruajtjen e shëndetit publik të popullatës.



# KDI-ja thotë se po vazhdon ngecja në luftën kundër korrupsionit në Kosovë

EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 28 JANAR - Rezultatet e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2020 konfirmojnë vazhdimin e ngecjes në luftën kundër korrupsionit. Për të dytin vit radhazi, Kosova shënoi 36 pikë, duke u renditur në pozitën e 104-t së bashku me Shqipërinë, Algjerinë, Bregun e Fildishtë, El Salvadorin, Vietnamin dhe Tajlandën. Transparency International (TI) përdor një metodologji shkencore dhe raportin e bazon kryesisht në raportet kredibile nga organizatat ndërkombëtare si Freedom House, World Bank, Bertelsmann Foundation, World Justice Project ROLI, Global Insight dhe Varieties of Democracy Project. Indeksi shfrytëzon sistemin e vlerësimit prej 100 shkallësh në të cilin vlerësimi maksimal do të thotë "vend i pastër nga korrupsioni", kurse vlerësimi prej zero pikë do të thotë "vend shumë i korruptuar".

Në aspektin global, nga 180 vende të përfshira në këtë vlerësim, Danimarka dhe Zelanda e Re ndajnë pozitën e parë me 88 pikë, të ndjekura nga

Finlanda, Singapori, Suedia dhe Zvicra me 85 pikë. Vendlin e fundit në botë e mban Somalia me 10 pikë, e pasuar nga Sudani Verior, Siria, Jemeni, Venezuela, Sudani, Koreja Veriore etj. Në nivel rajonal, krahasimi i rezultateve me ato të vitit të kaluar tregon se i gjithë rajoni po kalon nëpër një periudhë ngecje dhe vetëm Shqipëria ka shënuar një rritje me 1 pikë krahasuar me vitin e kaluar.

Është shumë me rëndësi që të tregohet edhe mesatarja globale, që është 43 pikë e që ne jemi ende larg kësaj mesatare, ndërsa mesatarja e Evropës, ku edhe pretendojmë të jemi pjesë, është 66 pikë. "Këto rezultate tregojnë që Kosova ka nevojë urgjente të përqendrohet në tri fusha në mënyrë që të bëjë përparim. 1. Pavarësia e sistemit të drejtësisë: Ndërhyrja e vazhdueshme politike në punën e gjyqësorit kanë minuar punën e pavarur dhe profesionale të sistemit gjyqësor në Kosovë; 2. Lufta kundërkorrupsionit: Përkundër ndryshimeve të fundit në legjislacion, krijimi i grupeve të punës dhe mekanizmat kundër nivelit të lartë të korrupsionit, lufta kundër korrupsionit vazhdon të mbetet një nga sfidat



kryesore të shoqërisë dhe institucioneve shtetërore të Kosovës. Hulumtimet vendore dhe ndërkombëtare flasin për nivele të larta të korrupsionit, nepotizmit, punësimit të bazuar në parti, emërimeve politike në bordet e ndërmarrjeve publike etj.; 3. Në fushën e prokurimit publik kërkohet të rritet transparenca në të gjitha fazat e procedurës së prokurimit, por me theks të veçantë kërkohet menaxhim dhe mbikëqyrje për

kontratat publike. Në këtë fushë vazhdimisht kemi kërkuar që të bëhet ngritja e nivelit të përgjegjësive së zyrtarëve publikë për mënyrën e shpenzimit të parasë publike", thuhet në komunikatën e KDI-së.

Po ashtu, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme si rezultat i Covid-19 me të cilin po përballet Kosova dhe mbarë bota, gjatë vitit 2020 prokurimi publik në masë të madhe është zhvilluar në procedura emergjente e cila

ka shkaktuar uljen e transparencës institucionale duke rritur mundësitë për korrupsion. "Në vitin 2020, gjatë blerjes së pajisjeve për masa mbrojtëse anti-Covid, ka pasur çmime të fryra në kontratat e lidhura nga institucionet publike, pra gjendja e jashtëzakonshme ka shkaktuar rritjen e mundësisë për korrupsion në sektorin e shëndetësisë në veçanti", është thënë në komunikatën e KDI-së.

## Lajçaku: Shkëmbimi i territoreve do të ishte shumë i rrezikshëm



PRISHTINË, 28 JANAR - Shkëmbimi i territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ishte "shumë i rrezikshëm", ka thënë për gazetën franceze "Le Monde", përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak. Sipas tij, dialogu i lehtësuar nga BE-ja është ndërprerë për shkak të zgjedhjeve në Kosovë. Duke folur për mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Serbisë, ai ka thënë

se "asgjë nuk ka mbaruar derisa gjithçka të ketë mbaruar". Në lidhje me rolin e Shteteve të Bashkuara në këtë proces, Lajçaku ka thënë se administrata e presidentit amerikan, Joe Biden, "ndien një përgjegjësi historike për shkak të angazhimit politik dhe njerëzor të ShBA-së në rajon".

I dërguari i BE-së për dialogun tha se BE-ja kishte bashkëpunuar më parë me sekretarin e ri të Shtetit në ShBA, Anthony Blinken dhe nënsekretarin për Çështjet

Politike, Victoria Nuland. "Uniteti amerikan-evropian është një faktor kryesor për suksesin në Ballkan", ka thënë Lajçaku.

I pyetur për idenë e shkëmbimit të territoreve midis Serbisë dhe Kosovës, Lajçaku u përgjigj se vendet e rajonit ishin kundër "sepse kanë frikë se ngjarjet mund të dalin jashtë çdo kontrolli".

Përveç kësaj, Bashkimi Evropian, sipas tij, ka investuar shumë në politikën e "evropianizimit dhe përfshirjes së Ballkanit në

familjen evropiane, që do të thotë në ndërtimin e shoqërive demokratike shumetnike" dhe "ridizajnimi i kufijve është në kundërshtim me atë ideal dhe do të nënkuptojë se ne kemi dështuar".

I pyetur se si e shikon rritjen e ndikimit të Kinës në Ballkan, ai tha se BE-ja është partnerja më e madhe tregtare, investitorja më e madhe në Ballkanin Perëndimor dhe ofron ndihmën më të madhe atje. "Ajo (Kina) nuk mund të ofrojë më shumë se ne", tha Lajçaku.

Dialogu politik në mes të Kosovës dhe Serbisë, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, ka nisur më 2011. Takimi i fundit në mes të krerëve shtetërorë të këtyre vendeve është zhvilluar në shtator të vitit të kaluar. Prej atëherë, nuk është zhvilluar takim i nivelit të lartë. Deri në zgjedhjen e Qeverisë së re të Kosovës, Brukseli zyrtar ka paralajmëruar se nuk do të ketë takime në kuadër të dialogut. Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbahen më 14 shkurt.

# Joefikasiteti i gjyqësorit po dekurajon investimet e huaja në Kosovë

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 JANAR - Përfaqësues të sistemit të drejtësisë në Kosovë, në kuadër të forumit virtual të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane, kanë vlerësuar se stagnimi i miratimit të Ligjit për Gjykatën Komerciale është pasojë e jostabilitetit politik në vend dhe nënvizuan se në rrethana të tjera ai do ta fuqizonte sistemin juridik. Në forum u tha se krijimi i gjykatës do ta përmirësonte mjedisin e të bërit biznes, njëkohësisht të gjitha metodat ligjore, përfshirë arbitrazhin dhe ndërmjetësimin, do të ndërlihdeshin me këtë gjykatë. "Duke vlerësuar se

sistemi i drejtësisë në Kosovë është përballur me sfida të mëdha, posaçërisht në kohë të pandemisë

COVID-19, përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë diskutuan edhe rreth çështjeve të efikasitetit të gjykatave, zgjidhjes së çështjeve komerciale gjatë periudhës së pandemisë, si dhe nevojës së promovimit të metodave alternative për zgjidhje të kontesteve", është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Mahir Tutuli, gjyqtar në Departamentin për Çështje Ekonomike në Gjykatën e Apelit, ka deklaruar se sistemi gjyqësor në vend është përballur me sfida të mëdha, me theks të veçantë

pas shpërthimit të pandemisë, pasi që masat kundër Covidit lejonin vetëm trajtimin e çështjeve esenciale, pa prani fizike. Sipas Tutulit, edhe pse ekziston baza teknike për të mbajtur seanca virtuale, varësisht nga natyra e rasteve, pjesa dërrmuese e sfidave me të cilat po përballet gjyqësori në Kosovë do të zgjidhet nga krijimi i gjykatës komerciale.

Rreth kësaj çështje ai ka thënë se e njëjta duhet të trajtohet me prioritet pasi që kjo gjykatë do ta përmirësonte dukshëm mjedisin e të bërit biznes në vend, ndërsa fuqizimi i kornizës ligjore për zgjidhjen e kontesteve komerciale do ta rriste sigurinë dhe do t'i tërhiqte investitorët e

huaj.

Për fund, ai theksoi edhe nevojën për promovimin e metodave alternative për zgjidhjen e kontesteve, siç është arbitrazhi, vendimet e të cilit njihen nga gjykatat si dhe lehtësojnë punën e tyre.

Avokati Taulant Hodaj ka theksuar nevojën për krijimin e kushteve për mbajtjen e seancave virtuale, për ta evituar mbingarkesën e gjykatave, si dhe për t'i përshpejtuar proceset gjyqësore për palët që kanë raste aktive në këto gjykata.

Duke u ndërlidhur me Gjykatën Komerciale, Hodaj ka thënë se duhet të mos përsëriten gabimet e së kaluarës, pasi që në rrethanat ku ndodhemi, kjo gjykatë do ta

fuqizojë sistemin juridik në vend si dhe zhvillimin e bizneseve.

Më tutje, avokati Hodaj ka theksuar se metodat ligjore, siç janë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, ndërlihdhen me veprimtaritë e Gjykatës Komerciale, prandaj organizatat si Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, aktorët e tjerë relevantë dhe institucionet shtetërore duhet t'i vazhdojnë përpjekjet e tyre për ta ngritur nivelin e njohurisë për ekzistencën e këtyre metodave, me theks të veçantë në komunitetin e biznesit. Hodaj ka përmbyllur forumin duke theksuar se arbitrazhi rekomandohet rregullisht nga përfaqësuesit ligjorë.



## Kosova dhe Zvicra nënshkruajnë marrëveshje për përmirësimin e mundësive për punësim

Ndërsa për shkak të ngricave po intervenohet për shpërndarjen e kripës në të gjitha rrugët e regionit të Prizrenit 2, M25 Prizren - Morinë, R115 Prizren - Prevallë, R113 Zhur - Dragash - Restelicë, R114 Dragash - Brod,

R222 Brezne - Zhur.

Peja është një nga komunat që ka pasur reshje më të mëdha të borës dhe është intervenuar në vazhdimësi për t'i mbajtur rrugët e qarkullueshme.

Në rrugën N9 Pejë - Bogë është bërë largimi i borës nga rruga me

hedhëse (frezë) pasi sasia e borës ka qenë e madhe dhe ka filluar ngushtimi i rrugës. "Është bërë shpërndarja e kripës kundër ngricave. Të gjitha rrugët janë të kalueshme për qarkullim", ka njoftuar Ministria e Infrastrukturës.





# ATK-ja mblodhi 78 milionë euro më pak gjatë vitit 2020

**EPOKA  
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 JANAR - Zëvendësuesi i drejtorit të përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ekrem Hysenaj, ka prezantuar raportin e punës për vitin 2020. Ai ka thënë se ATK-ja ka mbledhur 78 milionë euro apo 14 për qind më pak të hyra gjatë vitit 2020. Hysenaj ka thënë se aktivitetet e ATK-së për vitin 2020 ishin planifikuar si çdoherë bazuar në dokumentet strategjike, të cilat diktojnë planet e punës së ATK-së. Ai ka thënë se nga muaji mars

2020 të gjitha këto planifikime ndërruan rrjedhën, duke ulur në minimum aktivitetet e rregulla dhe duke u fokusuar në maksimum për zbatimin e masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ruajtjen e shëndetit të qytetarëve të saj, si dhe përkrahjen e bizneseve në forma të ndryshme. "Siç edhe e dini, bizneset kanë pësuar shumë nga pandemia. Vetë fakti që kemi pasur një rënie të qarkullimit të bizneseve për 1.2 miliard euro, ka ndikuar edhe në inkasimin e të hyrave të cilat krahasuar me vitin e kaluar kemi rënie për 5 për qind apo 24 milionë euro më

pak, ndërsa totali i të hyrave të inkasuara për vitin 2020 është 467 milionë euro. Po ashtu, ndikim të konsiderueshëm kemi pasur edhe në stokun e borxheve, ku nëse marrim parasysh ecurinë e trajtimit të borxheve më parë, pas reformave që kemi bërë në mbledhjen e detyrueshme, kemi pasur një ulje të theksuar të stokut të borxheve, por vështirësitë e krijuara te bizneset nga pandemia, kanë bërë që stoku i borxheve të rritet përsëri. Pavarësisht prej kësaj, ATK-ja në fazën e parë të pandemisë ka krijuar mekanizma të cilët u kanë

ndihmuar tatimpaguesve në riprogramimin e borxheve, ku numri i tatimpaguesve të cilët kanë bërë marrëveshje me ATK-në për riprogramim të borxheve është 1 556, me vlerë të obligimet për 75.6 milionë euro", ka thënë drejtori Hysenaj. Ai, po ashtu, ka potencuar se vlera e borxhit të inkasuar për vitin që lamë ishte 94 milionë euro. Ndër shumë të tjera dhe me interes ishte edhe prezantimi i sektorëve të cilët, sipas të dhënave të ATK-së, janë prekur më së shumti nga kjo pandemi. Drejtori i ATK-së ka vlerësuar se sektori i argëtimit dhe

rekreacioni ka pasur rënie prej 66-përqindësh, duke u pasuar nga sektori i aktiviteteve të patundshmërisë, me një rënie prej 27.9-përqindësh, sektori i akomodimit dhe shërbimit ushqimor, me 37.9 për qind etj. Në përfundim të konferencës drejtori Hysenaj ka thënë se ATK-ja dhe stafi i saj do të punojnë në maksimum për përmirësimin e situatës së krijuar nga rrethanat e pandemisë. Ai, po ashtu, u bëri thirrje bizneseve që të jenë pjesë e misionit të përbashkët për kthimin e normalitetit të ekonomisë së vendit, me theks të veçantë normaliteti tatimor.



## Qeveria lehtëson aktivitetin ekonomik të tatimpaguesve

PRISHTINË, 28 JANAR (ER) - Me sponsorim të Ministrisë së Financave, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për ta lehtësuar ushtrimin e aktivitetit ekonomik të të gjithë tatimpaguesve, si pasojë e

gjendjes së vështirësuar ekonomike të krijuar nga pandemia Covid-19. Përmes këtij vendimi shtyhet bllokimi i llogarive bankare për të gjithë tatimpaguesit që kanë obligime tatimore ndaj Administratës

Tatimore të Kosovës (ATK), deri më datë 30.04.2021; lirohen llogaritë e bllokuara të të gjithë tatimpaguesve që kanë obligime tatimore ndaj ATK-së, deri më 30.04.2021; hiqen ndëshkimet për të gjithë tatimpaguesit që

kanë detyrime tatimore të pashlyera në ATK, nëse kryejnë pagesën e tatimit bazë dhe interesit deri më 30.06.2021. Heqja e ndëshkimeve bëhet për të gjithë tatimpaguesit nëse: Tatimpaguesit bëjnë pagesën e

njëhershme të tatimit dhe interesit; tatimpaguesit bëjnë marrëveshje me ATK-në për pagesë me këste; dhe tatimpaguesit janë në marrëveshje me ATK-në dhe paguajnë tatimin dhe interesin.

## Më 4 shkurt do të mbahet ankandi i dytë i letrave me vlerë për vitin 2021

Prishtinë, 28 janar (ER) - Ministria e Financave ka njoftuar se më 4 shkurt do të mbahet ankandi i dytë për vitin 2021. Në këtë ankand do të emetohen obligacione

me maturitet trevjeçar në shumën prej 20 milionë eurosh. "Investimi në obligacione është investim i sigurt, i garantuar me Ligjin për Borxhin Publik, ku interesi i

përcaktuar nga tregu ju garantohet për të gjithë kohëzgjatjen (3 vjet) dhe është tërësisht i liruar nga tatimi. Për detaje rreth pjesëmarrjes në ankande për bler-

jen e letrave me vlerë, ju lutem kontaktoni ndonjërin nga bankat komerciale që operojnë në Republikën e Kosovës", thuhet në njoftimin e MF-së.



## Në Prizren realizohen 1 409 teste të shpejta antigjen për Covid

**PRIZREN, 28 JANAR (ER)** - Drejtorja e Shëndetësisë në Komunën e Prizrenit është duke vazhduar realizimin e testeve serologjike dhe të testeve të shpejta (rapide) antigjen për Covid-19. "Që nga fillimi i realizimit të këtyre testeve deri më tani janë kryer gjithsej: 1 409 teste të shpejta (rapide) antigjen dhe 12 660 teste serologjike. Testet e shpejta (rapide) antigjen,

rezultatet e të cilëve dalin brenda 10 minutave, kanë saktësi prej 98.8-përqindësh. Qytetarët e Komunës së Prizrenit mund t'i kryejnë testet duke marrë udhëzimin e mjekut të tyre familjar dhe duke u paraqitur në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Bajram Curr", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Ndërkaq testet serologjike për Covid-19, të cilët bëhen përmes gjakut dhe tregojnë nëse personi është ose ka qenë i infektuar me koronavirus, qytetarët e Komunës së Prizrenit mund t'i kryejnë në laboratorin e Qendrës së Mjekësisë Familjare 1, po ashtu me udhëzimin e mjekut familjar në QMF-të përkatëse ku banojnë.



## Miratohet kërkesa për ndarje të shujtave për punonjësit e Komunës së Mitrovicës



**MITROVICË, 28 JANAR (ER)** - Nën drejtimin e kryesuesit Safet Kamberi dhe në prani të kryetarit të komunës, Agim Bahtiri dhe bashkëpunëtorëve të tij, është mbajtur mbledhja e 41-të e rregullt e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në të cilën u shqyrtuan disa pika të rendit të ditës, që më parë kishin qenë temë diskutimi në mbledhjen e KPF-së. Në

këtë seancë u miratua kërkesa nga Sindikata e të Punësuarve të Komunës së Mitrovicës për ndarje të shujtës për punonjësit e komunës. Në përfundim të seancës janë diskutuar dhe janë miratuar edhe disa pika të tjera me rëndësi në këtë komunë, si propozim-vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për

vitin 2021; propozimvendimi për subvencionimin e Klubit të Basketbollit "Trepça"; propozimvendimi për subvencionimin e Klubit të Volejbollit "Trepça"; propozimvendimi për subvencionimin e Klubit të zhytjes "Trepça"; dhe kërkesën për mbështetje financiare nga Oda e Hotelierisë dhe Turizmit në Mitrovicë.

## Zemaj dhe Haziri vizitojnë 'Swiss Clinique 2', vlerësohet lart puna e kësaj klinike

**Gjilan, 28 janar (ER)** - Pas inaugurimit të laboratorit me metodën RT-PCR në Qendrën Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan dhe Qendrën e Oksigjenit në Spitalin e Përgjithshëm, ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, bashkë me kryetarin Lutfi Haziri, kanë vizituar klinikën kosovare-zvicerane të specializuar, "Swiss Clinique 2". Ata kanë parë nga afër punën e jashtëzakonshme që bëhet aty

me teknologjinë e fjalës së fundit, duke përgëzuar pronarin Bari Kastrati, i cili me investimet e tij nga mërgata, e bëri njërën prej klinikave më të mëdha në regjionin e Gjilanit, ku përfshihet edhe Kumanova, Presheva e Bujanoci. Ministri Zemaj e kryetari Haziri kanë shfaqur zotimin e përkrahjes me të gjitha mundësitë të sektorit privat të shëndetësisë, siç është "Swiss Clinique 2".



## Situata e sigurisë në Podujevë, e mirë

**Podujevë, 28 janar (ER)** - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Podujevës (KKS) ka mbajtur mbledhjen e rregullt në të cilën ka analizuar gjendjen e sigurisë në komunë dhe ka formuar grupin punues për përgatitjen e propozimplanit të punës së KKS-së për vitin 2021 dhe informatën për aktivitetet e këtij organi për vitin 2020. Lidhur me gjendjen e sigurisë në komunë, togerja Valbona Blakçori, shefe e Sektorit të Operativës në Stacionin Policor në Podujevë, ka thënë se gjendja e përgjithshme e sigurisë është e mirë.

Togerja Blakçori, duke raportuar për periudhën nga takimi i fundit i KKS-së, 23 tetor 2020 dhe 27 janar 2021, ka pohuar se gjatë kësaj periudhe në polici janë raportuar 825 raste të veprave të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe, sipas saj, ka pasur rritje të rasteve të dhunës në familje, ndërsa si sukses të policisë togerja e konsideron identifikimin dhe arrestimin e dy grupeve prej katër personave, që kanë kryer vjedhje të ndryshme. Ajo ka thënë se policia është duke zbatuar planin operativ që ka të bëjë me respektimin e masave kundër Covidit.

Blakçori ka thënë se krahas qytetarëve dhe bizneseve për mosrespektim të masave kundër koronavirusit, brenda një jave janë shqiptuar 20 gjoza edhe ndaj transportuesve publikë dhe udhëtarëve, për mosrespektim të distancës fizike dhe mosbartje të maskave. Kryetari i Komunës, Shpejtim Bulliqi, duke e vlerësuar të mirë situatën e sigurisë, ka thënë se nga marrja e detyrës në krye të komunës, është duke bashkëpunuar me organet e sigurisë, veçmas me komandantin e Stacionit Policor në Podujevë.



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (13)

# Çfarë përmbante aktakuza e fabrikuar për tetë ushtarët e Kazermës së Paraqinit?




Lulzim SAHITI

Për shtatë shokët e Azizit dhe të një ushtari nga Bosnjë e Hercegovina, periudha e hetimeve për hartimin e aktakuzës në Gjykatën Ushtarake të Nishit kishte nisur në fillim të shtatorit duke vazhduar deri në fund të muajit dhjetor të vitit 1997. Aktakuza e parë (dy faqe) ishte ndërtuar si "grup i organizuar me motive politike kundër Jugosllavisë". Në këtë aktakuzë i pari në listë ishte përfshirë shoku i ngushtë i Azizit, Afrim Mehmeti e, pas tij, të tjerët. Diku pas një muaji kishte ndryshuar gjithçka. I pari ishte radhitur Rizah Xhakli e të tjerët pas tij. Kjo kishte ndodhur pas grumbullimit të të dhënave nga Kosova, ku familja Xhakli ishte në listën e familjeve të përndjekura në vazhdimësi nga regjimi serb, prandaj jorastësisht ishte vendosur të ndëshkohej në krye të grupit. Kësaj radhe aktakuza ishte ndërtuar për "vepër penale të vrasjes nga nxitjet armiqësore ndaj RSFJ-së - në ndihmë, nga neni 122, lidhur me nenin 24-t të Ligjit Penal të RSFJ-së..."

Më 7 dhjetor 1987 (IK nr. 135/87) nga prokurori ushtarak, koloneli Zhitovije Bojiq, tetë të akuzuarve ua kishte dorëzuar aktakuzën e dytë, të shkruar me makinë shkrimi në 11 faqe të formatit A4.

Më 11 janar të vitit 1988, në Gjykatën Ushtarake të Nishit, filloi procesi politik i montuar fund e krye me akuza të kurdisura, të sajuara dhe të

trilluara, por tash e zgjeruar në 167 faqe të formatit A4. Me këtë rast u bë shqyrtimi kryesor rreth gjykimit të tetë ushtarëve të Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ) të akuzuar për pjesëmarrje dhe ndihmë më 3 shtator 1987 në ngjarjen e zhvilluar në Kazermën e Paraqinit që shkaktoi ushtari Aziz Kelmendi. Në aktakuzën e ngritur nga prokurori ushtarak, koloneli Zhitovije Bojiq thuhet: "Të akuzuarit Rizah Xhakli, Abdylxhemil Limani, Afrim Mehmeti, Pajazit Aliu, Shefqet Paçarizi dhe Enver Behluli, derisa ishin në shërbimin e afatit ushtarak në garnizonin e Paraqinit, më 2 shtator 1987, rreth orës 19.00, në fushën e basketbollit, e cila gjendet në rrethin e kazermës, ku ishin edhe Islam Mahmuti e Aziz Kelmendi, kanë dëgjuar se si ky i fundit, ushtar në postën ushtarake 7518 do t'i vrasë atë natë ushtarët Safet Dudakoviç e Milorad Vukoviç dhe se do t'i vrasë të gjithë ushtarët e postës ushtarake 5313 në Paraqin, duke kërkuar me këtë rast ndihmë prej tyre. Edhe pse e dinin se edhe më parë ai para tyre shprehte urrejtje ndaj pjesëtarëve të kombeve dhe kombësive të tjera nga pozita e nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, pranuan që t'i ndihmojnë në kryerjen e veprës së rëndë. Kur Azizi ka theksuar se nuk ka municion, Afrim Mehmeti i ka treguar se municion ka në dollapin që gjendet në korridorin e pavijonit, ndërsa i akuzuari Rizah Xhakli i ka thënë se lidhur me municionin do të bisedojë me komandantin e rojës Rizo Alibashiq, nga i cili do të sigurojë atë dhe se nuk do të ketë kurrfarë problemi. Kur Azizi ka theksuar se nuk di të përdorë pushkën automatike, Enver Behluli ka shkruar në çadrën e rojës dhe e ka sjellë



Aziz Kelmendi

pushkën automatike, ndërsa i akuzuari Pajazit Aliu i ka treguar Azizit se si përdoret ajo, si vihet e nxirret karikator dhe si shtihet me të. Azizi edhe ka treguar se atë natë do t'i vijë baba nga Gjermania dhe se pas krimin do të ikë. Me këtë rast i ka pyetur të akuzuarit Abdylxhemil Alimanin dhe Enver Behlulin se në çfarë kohe do të jenë në rojë atë natë të shkojnë kur t'i vijë babai dhe ta lajmërojë dhe pastaj ta lëshojnë të ikë. Këta janë pajtuar me këtë dhe me këtë rast janë marrë vesh që atë natë, kur Azizi ishte në detyrën e ndihmës të kujdestarit të njësisë t'i zgjojë nga gjumi të akuzuarit Rizah Gjakli, Afrim Mehmeti, Pajazit Aliu dhe Shefqet Paçarizi në mënyrë që të mos gjenden në dhomën kur ai të hapë zjarr.


Të njëjtën natë, rreth orës 20:30 minuta, Rizah Xhakli shkon në çadrën e komandantit të rojës, Rizo Alibashiqit dhe i tregon se Azizi do të vrasë Dudakoviçin e Vukoviçin dhe nga i njëjti kërkon municion. Alibashiq pajtohet t'u japë municion

Azizit, dhe merr vesh që marrja e municionit të inskenohet në atë mënyrë kinse ia ka marrë me dhunë dhe që në atë kohë të mos zgjohet nga gjumi kujdestari në çadrën e rojës, si dhe ndihmësi i komandantit të rojës. Rreth orës 21, në korridorin e pavijonit të njësisë, Rizahu, në praninë e Afrimit, Pajazitit dhe Shefqetit i lajmëron Azizit se ka biseduar me Alibashiqin dhe se ai do t'ia japë municionin, ndërsa pas kësaj një gjysmë ore më vonë, në të njëjtin vend Azizi para të akuzuarve të njëjtë përsëritë atë që tha edhe më parë se do të vrasë ushtarët e postës ushtarake 5313 dhe sipas marrëveshjes, rreth orës 2:30 minuta, Azizi i zgjon nga gjumi Rizahun, Afrimin, Pajazitin dhe Shefqetin.

Pas kësaj Rizahu zgjon të akuzuarin Islam Mahmutin dhe këta pastaj së bashku me Azizit, nga pavijoni shkojnë në vendrojen numër 1 të Abdylxhemil Alimani, të cilin Azizi e pyet se a mos i ka ardhur babai. Pasi i tregon se nuk ka ardhur, me kërkesën e Azizit, Afrimi e Shefqeti dalin nga

rrethi i kazermës dhe shkojnë në autostradë për të shikuar kur do të vijë babai i Azizit. Në ndërkohë kthehet Azizi në pavijon ku then dollapin e metaltë dhe merr 10 fishekë të kalibrit 7,62 milimetra dhe në korridor merr pushkën automatike. Sërish shkon në vendin e rojës të Abdylxhemili ku merr një karikator me 30 plumba të kalibrit 7,62 milimetra. Me këtë rast Rizahu e pyet Azizit për se merr fishekë të Abdylxhemili kur ai i ka siguruar te Alibashiqi. Pas kësaj rreth orës 3:00 Azizi shkon me pushkë te Alibashiqi në çadrën e rojës dhe sipas marrëveshjes së mëparshme me Rizahun, Alibashiq i jep atij dy karikatorë me nga 30 fishekë të kalibrit 7,62 milimetra. Pasi që armatoset mirë Azizi shkon në pavijon dhe së pari hap zjarr në dhomën numër 42 ku vret Safet Dudakoviçin, Srgjan Simiqin, Goran Begiqin dhe plagosë Ante Jazhiqin e Nexhip Mehmedoviçin, pastaj shkon në dhomën numër 41 ku vret Hasim Gjananoviçin e plagosë Andrej Presherinin, Petar Gjekiçin e Huso Kovaçoviçin. Nazif Axhoviç për të shpëtuar nga më e keqja kërcen nga dritarja në një lartësi prej 6 metrash me ç'rast merr lëndime të lehta. Pas shkakimit të krimin të rëndë Azizi shkon në rojën numër 1 dhe Abdylxhemilit ia kthen karikatorin me 30 plumba dhe pyet se mos ka ardhur babai i tij. Aty ishin edhe Rizahu, Afrimi, Pajaziti e Shefqeti, të cilët pastaj kthehen në pavijon dhe përzihen me ushtarë të tjerë. Vrasësi mizor ikën nga rrethi i kazermës, pastaj në malin e afërt bën vetëvrasje", përfundon aktakuza.

Sipas kësaj aktakuze, të lartpërmendurit kanë bërë vepër penale të vrasjes nga nxitjet armiqësore ndaj RSFJ-së - në ndihmë, nga neni 122, lidhur me nenin 24 të Ligjit Penal të RSFJ-së, ndërsa Abdylxhemil Alimani edhe për vepër penale të cenimit të detyrës së rojës nga neni 209, paragrafi 1 i Ligjit Penal të RSFJ-së. Ndërkaq, Rizo Alibashiq akuzohet edhe për vepër penale të vrasjes në ndihmë nga neni 47, paragrafi 2, pika 1 dhe 3 i Ligjit Penal të Serbisë, lidhur me nenin 24 të Ligjit Penal të RSFJ-së për vepër penale të cenimit të rojës, ndërsa i akuzuari i fundit Islam Mahmuti, për vepër penale të moslajmërimit të përgatitjes së veprës penale nga neni 202, paragrafi 2 i Ligjit Penal të Serbisë. (Vijon)



Faksimile nga aktakuza e dytë, 7 dhjetor 1987



QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'  
TEL: 045/82 82 82

## Ponte Prizreni triumfon ndaj Rahovecin, Trepça mposhti Vëllaznimin

PRIZREN, 28 JANAR - KB Ponte Prizreni ka fituar ndaj Rahovecin në udhëtim 87:98 (20:33, 21:15, 20:24, 26:26), në kuadër të javës së 18-të në Superligës së Kosovës në basketboll. Mysafirët e nisën më mirë ndeshjen, duke pasur epërsi deri në 15 pikë në çerekun e parë, kurse rezultati i kësaj pjese ishte 20:33. Vendasit kundërpërgjigjen në periudhën e dytë, duke e fituar 21:15, kurse skuadrat shkuan në pushim me rezultat 41:48. Prizrenasit kishin epërsi deri në 14 pikë në periodën e tretë, 50:64, ndërsa rezultati pas 30 minutash në semafor ishte 61:72. 10 minutat e fundit ishin kryesisht të barabartë, derisa Ponte Prizreni triumfon në fund 87:98. Te Rahoveci u dallua Isaiah Traylor me 21 pikë e shtatë asistime, kurse te Ponte Prizreni u dalluan Arti Hajdari me 22 pikë e shtatë asistime dhe Xavier Cannefax me 22 pikë, 7 kërcime

dhe 8 asistime. Rahoveci ka 12 fitore dhe gjashtë humbje, kurse Ponte Prizreni 13 fitore dhe pesë humbje. Trepça ka shënuar fitore të rëndësishme ndaj Vëllaznimit në udhëtim me shifrat 82:83 (13:10, 23:28, 22:19, 24:26), në kuadër të javës së 18-të në Superligën e Kosovës në basketboll. Loja e baraspeshuar u zhvillua në çerekun e parë, me vendasit që fituan këtë pjesë për vetëm tri pikë, 13:10. Kuqezinjtë vazhduan me lojë të mirë edhe në periudhën e dytë, duke pasur epërsi në dhjetë pikë, 29:19, por më pas mysafirët hyjnë në një seri të suksesshme dhe përfundojnë pjesën e parë me dy pikë epërsi, 36:38. Perioda e tretë ishte mjaft e barabartë, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej në epërsi, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 58:57. 10 minutat e fundit ishin mjaft interesant. Pas një fillimi të barabartë, mysafirët kishin

epërsi në gjashtë, por vendasit nuk dorëzohen, megjithatë vetëm ngushtuan shifrat në 82:83, pa arritur të bëjnë më shumë. Te Vëllaznimi u dalluan Cedric Council me 18 pikë e 10 kërcime, Emmanuel Emogbo me 14 pikë e 14 kërcime dhe Robert Shestani me 18 pikë e 8 asistime, kurse te Trepça më i miri ishte Drilon Hajrizi me 34 pikë e 13 kërcime.

### Prishtina dhe Bashkimi në finalen e madhe

Prishtina dhe Bashkimi janë skuadrat e kualifikuara në finalen e Kupës së Kosovës në basketboll në konkurrencën e femrave. Prishtina ka mundur në udhëtim Vëllaznimin 66:89 (20:24, 15:20, 14:19, 17:26). Skuadra prishtinase fitoi të gjithë çerekët dhe u kualifikua në finale, që do të zhvillohet më 7 shkurt në Suharekë. Te Vëllaznimu u dallua Sarah



Mgbeike me 25 pikë dhe 24 kërcime, kurse te Prishtina, Enxhi Khanaj me 20 pikë e 18 kërcime dhe Alexis Tolefree me 34 pikë. Ndërkohë, ndeshje më interesante u zhvillua ndërmjet Bashkimit dhe Penzës, ku skuadra prizrenase fitoi 80:76 (22:12, 14:17, 23:15, 21:32). Vashat prizrenase fituan çerekun e parë 22:12, derisa në periudhën e dytë më të mira ishin ato mysafire 14:17.

Vendaset sërish ishin më të mira në periodën e tretë 23:15. Lojë mjaft interesante u zhvillua në periudhën e fundit, ku Penza arrin të afrojë rezultatin në 72:71, megjithatë, Bashkimi ishte më i përqendruar në fund dhe triumfoi 80:76. Te Bashkimi u dallua Lejzae Davidson me 36 pikë, kurse te Penza u dalluan Gabrielle Cooper me 21 pikë e 11 kërcime Ashlie Howwel me 17 pikë dhe 13 kërcime.

## Pupovci fiton normën olimpike për LOD 'Beijing 2022'



PRISHTINË, 28 JANAR - Skitari i Kosovës, Arbi Pupovci, e ka fituar normën olimpike në disiplinën e sllallomit për Lojërat Olimpike Dimërore "Pekin 2022", të cilat mbahen në shkurt të vitit të ardhshëm në Pekin të Kinës. Pupovci fitoi të enjten medaljen e bronzitë në garën e Pamporovos së Bullgarisë. Ai përfundoi me kohë 2 minuta, 0 sekonda e 18 të

qindtat pas dy lëshimeve. Pjesëmarrës në garë ishin 20 garues, nëntë prej të cilëve nuk arritën ta përfundojnë njërën nga dy lëshimet. Me këtë rezultat, Arbi çoi në pesë numrin e rezultateve të nevojshme për normën olimpike. Në Pamporovo garuan edhe Drin Kokaj e Kiana Kryeziu. Kokaj doli i shtati, ndërsa Kiana ishte e pafat duke u diskualifikuar në

konkurrencën e femrave. Përzgjedhësi i Kosovës, Agim Pupovci, u shpreh i lumtur me arritjen e normës olimpike, duke thënë se me pak përkrahje Arbi do të arrijë rezultate edhe më të mira. Sipas tij, Drini bëri disa gabime, gjë që ka mundur të ketë pozitë edhe më të mirë, ndërsa Kiana ishte e pafat. Arbi është bursist i KOK-ut për LOD Pekin 2022.

## Kosova në mars zhvillon miqësore ndaj Lituanisë



PRISHTINË, 28 JANAR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll do të luajë një ndeshje miqësore në muajin mars kundër Kombëtares së Lituanisë. Njoftimi është bërë nga Federata e Futbollit të Kosovës. Kjo ndeshje zhvillohet në prag të ndeshjeve kualifikuese për

Botërorin 2022 dhe zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri". "Përfaqësuesja e Kosovës do të luajë miqësore me Kombëtaren e Lituanisë në prag të ndeshjeve kualifikuese për Botërorin 2022. Marrëveshja ndërmjet dy federatave tashmë është arritur dhe ndeshja do të zhvillohet më

24 mars në Prishtinë. Katër ditë pas kësaj miqësoreje, 'dardanët' do ta zhvillojnë ndeshjen e parë në kuadër të kualifikimeve të Botërorit kundër Suedisë, po ashtu si vendës, teksa më 31 mars do të jenë mysafirë të Spanjës", thuhet në njoftimin e FFK-së.

## Liria dhe Besa në Durrës

PRIZREN, 28 JANAR - Liria e Prizrenit për dy javë do t'i vazhdojë përgatitjet në Durrës të Shqipërisë. Gjatë qëndrimit në bregdetin shqiptar, skuadra që bën gara në Ligën e Parë, pos stërvitjeve, do t'i zhvillojë edhe disa ndeshje miqësore. Kushtet

që ofron klima detare dhe ambienti në "Hotel Bonita" do të jenë shtytje për punë edhe më të madhe. "Jemi fokusuar, pos për sjelljen e përfundimeve, të kemi edhe përgatitje sa më cilësore. Objektivi ynë mbetet lufta për kthim në elitë", ka thënë kryetari i

klubit, Qemal Krasniqi. Ndërsa nga e marta në Durrës është edhe skuadra e Besës së Pejës, e cila po përgatitet për sezonin pranveror. Pejanët që janë në pozitën e fundit në Superligë të shtunën do të zhvillojnë një ndeshje miqësore me Besën e Kavajës.



## Murray, për shkak të Covidit, mungon në 'Australian Open'

LONDËR, 28 JANAR - Tenisti britanik Andy Murray, ish-numri 1 në botë për meshkuj, nuk do të luajë në grand slam të "Australian Open" që nis më 8 shkurt. Ai doli pozitiv me koronavirus dy javë më parë, duke hyrë menjëherë

në izolim në Londër. Përveç kësaj, ai humbi edhe mundësinë që të shkonte në Melburn në kohë, ashtu si tenistët e tjerë, për të bërë dy javë karantinë (rregull për të gjithë të huajt që vijnë në Australi). Murray shpresonte në

një marrëveshje me organizatorët e këtij turneu, që të kishte mundësi të stërvitej gjatë kohës që ishte në karantinë në Australi dhe të ishte gati më 8 shkurt por, pa sukses. Për pasojë, ai ka vendosur të mos udhëtojë.

"Biseduam gjatë gjithë kohës me Tennis Australia për të gjetur një zgjidhje të mirë për mua, që të kisha mundësi të stërvitesha gjatë karantinës por, pa sukses. Më vjen keq që nuk do të luaj në këtë turne", ka thënë Murray.



## Kosova sërish në të njëjtin grup me Anglinë dhe Shqipërinë

NION, 28 JANAR - Kombëtarja shqiptare e futbollit për moshën U-21 është njohur me kundërshtarët e saj në eliminoret e Kampionatit Evropian 2023. Shorti i hedhur në selinë e UEFA-s, në Nion të Zvicrës, e vendosi Shqipërinë në Grupin G bashkë me Anglinë, Republikën Çeke, Slloveninë, Kosovën dhe Andorrën. Tri nga këto skuadra, e më konkretisht Anglinë, Kosovën dhe Andorrën, kuqezinjtë i kishin rivalë edhe në eliminoret e Kampionatit Evropian 2021, që u mbyllën nëntorin e vitit të kaluar. Ndeshjet e grupeve të Evropianit për moshën U-21 do të luhen duke filluar nga muaji mars 2021 e deri në qershor të vitit 2022, ndërsa ndeshjet e fazës "play-off" do të luhen në shtator të vitit 2022. Faza finale e këtij turneu do të zhvillohet në muajt qershor-korrik 2023, raporton "Supersport". Shorti përcaktoi

POZ. 1	POZ. 2	POZ. 3	POZ. 4
1. Greqi	1. Azeria	1. Sllovakia	1. Letonia
2. Gjermania	2. Polonia	2. Letonia	2. Libria
3. Franca	3. Suedia	3. Libria	3. Sllovakia
4. Evropa	4. Çekia Republika	4. Republika e Irlandës	4. Izraeli
5. Danimarka	5. Belgjia	5. Izraeli	5. Norvegjia
6. Portugali	6. Rusia	6. Bullgaria	6. Turqia
7. Holanda	7. Serbia	7. Bullgaria	7. Turqia
8. Kroacia	8. Suedia	8. Bullgaria	8. Turqia
	9. Greqia		

9 grupet e fazës eliminatorie të Evropianit, nga të cilat 8 janë me nga 6 skuadra, ndërsa një grup ka 5 skuadra. Nëntë vendet e para të grupeve do të kualifikohen direkt për në fazën finale së bashku edhe me vendin e dytë më të mirë të eliminatorëve. Ndërsa tetë vendet e tjera të dyta do të përballen në "play-off" për t'i përcaktuar edhe katër skuadrat e fundit që do ta sigurojnë biletën për në fazën finale të

Evropianit. Pas një fushate të suksesshme në eliminoret e Evropianit të kaluar, kuqezinjtë u ngjiten këtë herë në vazon e katër nga gjashtë në total së bashku me skuadra si Skocia, Uells, Hungaria, Finlanda, Irlanda e Veriut, Bosnje-Hercegovina, Bjellorusia dhe Maqedonia e Veriut. Paraqitjet e fundit pozitive të skuadrës së drejtuar nga trajneri Alban Bushi e kanë ngjitur Shqipërinë në renditjen e UEFA-s.

## 13 gjyqtarë të Kosovës marrin stemën e FIFA-s

Prishtinë, 28 janar - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu dhe kryetari i Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, kanë prit sot në takim 13 gjyqtarë të futbollit, të cilëve u janë dorëzuar stemat e reja të FIFA-s. Numri një i FFK-së, Ademi, ka përgëzuar gjyqtarët me stemën e FIFA-s, teksa ka thënë se, përveç si privilegj, kjo stemë është edhe përgjegjësi për secilin prej tyre. I pari i shtëpisë më të madhe të futbollit të Kosovës ka kërkuar nga gjyqtarët që në stinorin pranveror të jenë vigjilentë dhe ta kryejnë punën me profesionalizëm maksimal dhe të jenë shembull për gjyqtarët e rinj, të cilët synojnë të arrijnë në këtë nivel. Për herë të parë me stemën e FIFA-s është pajisur gjyqtarja e futbollit, Florentina Kallaba, derisa gjyqtarët e tjerë kanë qenë të pajisur me këtë stemë edhe në vitin e kaluar.



### GJYQTARË KRYESORË

Genç Nuza  
Besfort Kasumi  
Visar Kastrati

### ASISTENTË

Lumturije Muhadri  
Fatlum Berisha  
Bujar Selimaj

Fatmir Sekiraga  
Edmond Zeqiri  
Imran Kabashi  
Besnik Morina

### GJYQTARË TË FUTSALLIT

Besar Beqiri  
Besart Ismajli  
Florentina Kallaba

## Erikseni nuk do të largohet nga Interi

Christian Eriksen raportohe se ka bindur trajnerin Antonio Conte që të mos e largojë nga klubi, raporton "Il Corriere dello Sport". 28-vjeçari ka

qenë i lidhur për një rikthim në Ligën Angleze javët e fundit, me klubet e interesuara Tottenham, Arsenal dhe Leicester. Përveç

kësaj, ardhja e Mauricio Pochettino në Paris Saint-Germain ndezi thashethemet për një ribashkim të mundshëm në kryeqytetin

francez. Eriksen shënoi fituesin në Derbin della Madonnina, kur Interi mundi Milanin 2-1 për të vendosur një gjysmëfinale kundër

Juventusit. Raporti pretendon se Interi nuk po konsideron një shitje këtë dimër dhe Erikseni, në fund të fundit, duhet të qëndrojë i vendosur.

### SHKURT

#### Osijeku planifikon huazimin e Grezdës

Futbollisti shqiptar Eros Grezda është rikthyer së fundmi nga një dëmtim në kavigj. Sulmuesi kuqeziu u detyrua të bënte dy herë ndërhyrje kirurgjikale dhe tanimë është gati për t'u rikthyer në fushë. Mediat kroate bëjnë me dije se Osijeku ka në plan huazimin e tij që të mund të marrë minuta dhe të rikthehet në formë. Nuk dihet nëse sulmuesi do ta pranohet këtë.

#### Gjimshiti: Ky është sekreti i suksesit të Atalantës

Berat Gjimeshi ishte protagonist në fitoren spektakolare me shifrat 3-2 të Atalantës ndaj Lazios, sukses që i kualifikoi bergamaskët në gjysmëfinale të Kupës së Italisë. Edhe pse me 10 lojtarë që në minutën e 54-t pas daljes me karton të kuq të Palominos, Atalanta arriti ta realizonte golin e fitores 3-2 me rusin Miranchuk. "Ishte një ndeshje e veçantë dhe shijua një futboll sulmues. Pjesa e parë ishte e ekuilibruar, ishte një përballje shumë e bukur për t'u parë, por pati edhe goxha gabime. Më pas doli në pah karakteri i Atalantës. Nëse kthejmë kokën pas, mund të them që këtë lloj takimi nuk do ta kishim fituar dot dy vjet më parë. Vuajtëm shumë, por ia dolëm të fitojmë dhe të kualifikohemi në gjysmëfinale. Shumë gola nga mbrojtësit tek Atalanta? Detyra jonë kryesore është të mbrojmë. Më pas mendojmë për sulmin. Trajneri na kërkoi gjithmonë ta dërgojmë topin në rrjetë në momentin që kundërshtari nuk e pret. Ky është sekreti ynë", ka thënë mbrojtësi shqiptar.

#### Llorente përforcon Udinesen

Sulmuesi Fernando Llorente është transferuar edhe zyrtarisht në Udinese nga Napoli. 35-vjeçari ka firmosur kontratë me Udinesen deri në verën e vitit 2022. Llorente ka luajtur me sukses edhe për Juventusin në Itali, derisa ishte pjesë edhe e Tottenham Hotspurit, Sevilias, Swansea Cityt dhe Athletic Bilbaos.

#### Kroosi e synon sërish Ligën e Kampionëve

Toni Kroos po synon titullin e pestë të Ligës së Kampionëve me Realin e Madridit. Mesfushori gjerman është pjesë e Realit nga viti 2014 dhe gjatë kësaj kohe ka fituar tri herë Ligën e Kampionëve, ndërsa një trofe e kishte fituar në vitin 2013 me Bayern Munchenin. "Kur e ke mësuar ndjenjën e fitimit të Ligës së Kampionëve, dëshiron ta ndiesh përsëri dhe përsëri", ka thënë Kroos për "AS". "Ndoshta nuk do t'ia dalësh brenda disa vjetësh, duke qenë se edhe të tjerët duan ta dinë se si është, por dëshira për ta rijetuar përvojën, nuk zhduket", ka shtuar Kroos.

#### IFFHS-ja shpall formacionin më të mirë të dekadës së fundit

Ekipi i lojtarëve më të mirë në botë i dekadës së fundit (2011-2020) është shpallur nga IFFHS-ja dhe vetëm një lojtar i Premierligës bën pjesë në 11-shën përfundimtare. IFFHS-ja ka bërë publikimin e shumë formacioneve dhe ka dhënë çmime të ndryshme këtë vit. Formacionet: Manuel Neuer, Philipp Lahm, Sergio Ramos, Virgil Van Dijk, Marcelo, Luka Modriç, Andres Iniesta, Toni Kroos, Lionel Messi, Robert Lewandowski, Cristiano Ronaldo.



## K O N K U R S

**Pozita e punës:** Asistente e KE-së ( 1 pozitë )

**Kohëzgjatja e kontratës:** 1 vit me mundësi vazhdimi

**Orari i punës:** I plotë.

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Është përgjegjës/e për pranimin e palëve të KE, përkatësisht caktimin e terminëve për takime të KE me palët;
- Pranon postën dhe pas kontrollimit nga KE, bën shpërndarjen e të njëjtës;
- Planifikon orarin e takimeve zyrtare të KE dhe informon palët zyrtare për takimet.
- Pranon thirrje telefonike;
- Kujdeset për furnizim me kohë të materialit shpenzues;
- Mban evidencën e shpenzimeve të KE për reprezentacion brenda ndërmarrjes;
- Kujdeset për përgatitjen me kohë të materialeve të KE, si hartimi, përkthimi, shumëzimi, arkivimi, shpërndarja etj;
- Kujdeset për mirëmbajtjen përkatësisht kushtet higjienike-teknike të zyrës së KE;
- Është përgjegjëse për përdorimin dhe pranimin e email-ve zyrtar të Ndërmarrjes;
- Është personi, si dhe pika e parë kontaktuese e kabinetit të KE me të gjitha njësitë punuese tjera,
- Bën interpretimin e planit ditor të kabinetit të KE,
- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së KE, të cilat për nga natyra i përkasin këtyre detyrave të punës;
- Për punën e tij/saj i përgjigjet KE.

### Përgatitja profesionale

1. Diploma Universitare: Juridik, Administratë Publike, Ekonomik ose Menaxhment;
2. Përvoja e punës përparësi;
3. Kopje të letërnjoftimit;
4. Aftësi të mira të punës me kompjuter;
5. Gjuha Angleze përparësi.

### Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidatja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com);

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>);
2. Dëshmi mbi shkollimi;
3. Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse posedon).
4. Kopja e letërnjoftimit;

-Çdo përgënjeshtër i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në s'kualifikimin e menjëhershëm.

### Informata të përgjithshme:

-Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.

-Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.

### Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes e-mailit: [punesimi@trafikurban-pr.com](mailto:punesimi@trafikurban-pr.com).

Konkursi është i hapur nga data **29.01.2021** dhe përfundon më datë **12.02.2021** në ora 24:00.

NPK "Trafiku Urban" SHA  
Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë  
web: [www.trafikurban-pr.com](http://www.trafikurban-pr.com) email: [info@trafikurban-pr.com](mailto:info@trafikurban-pr.com) tel: +383 (0) 45 10 11 23

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Matkos Group" Sh.p.k. Veternik, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndryshimin e lokacionit të trases për vëndosjen e gypave të hidrocentralit Sharri, komuna e Shtërpçës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.02.2021 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "Majestic" afer rrugës Shtëpçë – Prizren në Brezovicë komuna e Shtërpçës do të organizohet debat publik nga kompania "Matkos Group" Sh.p.k. Veternik, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndryshimin e lokacionit të trases për vëndosjen e gypave të hidrocentralit Sharri, komuna e Shtërpçës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://zoom.us/j/94173453334?pwd=QlIGbDRaaWFFcFcxUkp1Vdc0Y3owZz09>

Zoom ID: 941 7345 3334

Passwordi: Y6J4th

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Matkos Group" Sh.p.k. Veternik, Prishtinë për ndryshimin e lokacionit të trases për vëndosjen e gypave të hidrocentralit Sharri, komuna e Shtërpçës.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

<https://mea.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publicimet/Matkos%20group%20Ndryshim%20i%20trases%20te%20gypave%20te%20HC%20Sharri.pdf>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "EcoDri" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

## DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e hidrocentralit "EcoDri" në lumin Drini i Bardhë, komuna e Prizrenit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.02.2021 në ora 11:00 në hapësirat e restorant "URA" rruga "Beteja e Drinit" fshati Dobrushë komuna e Prizrenit do të organizohet debat publik nga kompania "EcoDri" Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për ndërtimin e hidrocentralit "EcoDri" në lumin Drini i Bardhë, komuna e Prizrenit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/6947649408?pwd=MHVwR0JFQnJqaGxUUW5NStkdVFHdz09>

Meeting ID: 694 764 9408

Passcode: 69NdnE

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "EcoDri" Sh.p.k. Prishtinë për ndërtimin e hidrocentralit "EcoDri" në lumin Drini i Bardhë, komuna e Prizrenit.

[https://mea.rks-gov.net/dokumentet\\_dhe\\_publicimet/279/publicimet](https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet)

[https://mea.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publicimet/VNM\\_Ecodri.pdf](https://mea.rks-gov.net/assets/cms/uploads/files/Publicimet/VNM_Ecodri.pdf)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**NJOFTIM**


Njoftojmë të gjithë klientët se “ELECTRONIC-H&M” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811126566, Rogovë-Gjakovë, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “ELECTRONIC-H&M” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811126566, Rogovë-Gjakovë ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

All clients are to be informed that the “ELECTRONIC-H&M” L.L.C. has come to the decision to quit its nr: 811126566, Rogovë-Gjakovë the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

**RESTAURANT****SWISS  
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

► “OSC Group” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811348855 me seli në Viti.

► Doruntina Zogiani shpall të humbur diplomën e Fakultetit të FSHMN-së drejtimi Fizikë -arsimore, në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, data e lëshimit diplomës 12 shkurt 2007.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoh një banesë me qira në Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzegjzë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbrërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI

**AGRON SHALA**

**DEKALOGU**

『nga Moisiu deri te Kieślowski』

ÇMIMI: 5.99 €



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjstruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.

4<sup>99</sup> €



Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

**Daut Dauti**  
**NJË PALË KËPUCË NË BERLIN**

novelë









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

